



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the
General Secretary

Nr. 90 /2025
Datë: 20/06/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar nënin 63 (paragrafi 1, nën paragrafit 1.1 dhe 2) të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M
për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil

1. Z. Lulzim Beqiri nga pozita Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Drejtësisë, për interes të institucionit transferohet përkohësisht në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, në Ministrinë e Drejtësisë për një periudhë gjashtë (6) muaj, nga data e transferimit, nëse brenda kësaj periudhe nuk plotësohet pozita sipas procedurës së rekrutimit ose nuk nxirret vendim tjetër lidhur me këtë pozitë.
2. Në zbatim të Rregullores ZKM-nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të kësaj pozite, në pajtim me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. Obligohet njësia përgjegjëse për burime njerëzore dhe njësia përgjegjëse për buxhet që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës për të cilën është caktuar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Lulzim Beqiri;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.